



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:186977

Datë: 21.03.2025

Numri i dokumentit: 07024678

Ac.nr.7604/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Hunaida Pasuli dhe Nehat Idrizi, anëtar të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Xhennet Shantir, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.B nga fshati P, Komuna e Prizrenit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Agron Hoti, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Blerim Mazreku, avokat nga Prizreni, me objekt kontesti kompensimi i diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.****/21, të datës 30.08.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.03.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren, PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.****/21, të datës 30.08.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.****/21, të datës 30.08.2022, në pikën I (një) të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses L.B nga Prizreni dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit që për periudhën kohore 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021 në emër të kompensimit mbi bazën e

kualifikimit t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 2,661.36 €, me kamatë prej 8% në vit, duke filluar nga dita e data e parashtrimit të padisë (24.08.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha në afatin prej 7 ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit e ka detyruar të paditurën që t'ia paguaj paditëses shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 124 €, në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë e paditura nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, duke e atakuar të njëjtin, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të aprovohet si e bazuar, të prishet aktgjykimi i ankimuar dhe të hedhet poshtë padia e paditëses apo të prishet aktgjykimi i ankimuar dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësja nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, në afat ligjor ka paraqitur përgjigje në ankesë, duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet, duke kërkuar shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në ankesë në shumë prej 208.00 €, sipas nr. tarifor 6 lidhur me nr. tarifor 9 të rregullores së avokatëve.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja L.B, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me datë 24.08.2021 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës, për shkak të kompensimit të diferencës së pagës së kualifikimit të papaguar, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas vlerësimit të pretendimeve nga padia, përgjigja në padi dhe provave shkresore pa shqyrtim kryesor të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.****/21, të datës 30.08.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se në mes të palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, SH.F.M.U "D" në Prizren, në cilësinë e mësimdhënëses, por mbetet kontestues fakti se paditëses a i takon shpërblimi për kompensimin mbi bazën e kualifikimit për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar, me arsyetimin se kjo kërkesë e paditëses është e rregulluar me dispozita të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, konkretisht nenin 7 paragrafi 1 i cili rregullon çështjen e kompensimit mbi bazën e kualifikimit. Duke shtuar se bazuar në këto dispozita materiale të cilat

përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjygjëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësja është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar kërkesë padinë e paditëses, ashtu që e detyroj të paditurën që t'ia paguaj kompensimin mbi bazën e kualifikimit prej 27% të pagës bazë për shkak se është e kualifikuar me diplomë fakulteti. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, vendosi sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Lidhur me mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 7 paragrafi 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017, ndërsa lidhur me vendimin për kamatën gjykata është bazuar në nenin 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.*/2020, të datës 02.12.2020, ndërsa lidhur me shpenzimet procedurale është bazuar në nenin 449, 452 dhe 453 paragrafi 1 të LPK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar si të rregullt dhe të bazuar në ligj nuk e përkrah Gjykata e Apelit, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n), (o) dhe neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 160 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së. Gjendja faktike po ashtu del të mos jetë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ku për rrjedhojë ka pasur edhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale për të cilën Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 194 të LPK-së kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në këtë kuptim, Gjykata e Apelit i pranon si të qëndrueshme pretendimet ankimore të të paditurës përmes të cilave e njëjta e atakon aktgjykimin në fjalë, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe paqartësive të tjera që evidentohen në të. Kjo për faktin se e tërë struktura dhe përmbajtja e aktgjykimit është në kundërshtim me kërkesat e vëna nga neni 160 i LPK-së, dispozitat e të cilit përcaktojnë atë që duhet të përmbajë një dispozitiv dhe një arsyetim i një aktgjykimi. Paragrafi 3 i këtij neni përcakton se si duhet të jetë një dispozitiv i qartë dhe i ligjshëm i një vendimi gjyqësor. Në rastin konkret, të metat thelbësore si pasojë e të cilave Gjykata e Apelit nuk mund të pranojë ligjshmërinë e aktgjykimit të shkallës së parë, evidentohen pikërisht në pjesën e dispozitivit dhe të arsytimit.

Si rrjedhojë, aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) dhe (o) të LPK-së dhe neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 160 paragrafi 3 të LPK-së, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i përgjithësuar dhe konfuz në vete, e si i tillë del të jetë i paqartë dhe i pa ekzekutueshëm, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në dispozitivin e aktgjykimit e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses në emër të kompensimit mbi bazën e kualifikimit dhe sa i përket periudhës kohore i ka përfshirë vitet 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021, në anën tjetër nëse i referohemi petitumit të padisë së paraqitur me datë 24.08.2021, e cila në bazë të shkresave të lëndës del që të mos jetë e ndryshuar apo e precizuar më vonë nga ana e paditëses, periudha kohore për të cilën kërkohet kompensimi mbi bazën e kualifikimit përfshinë 9 muaj të vitit 2017, 12 muaj të viteve 2018, 2019, 2020 dhe 7 muaj të vitit 2021, çka kjo e bënë dispozitivin të paqartë, konfuz dhe të pa ekzekutueshëm. Në këtë drejtim, është kërkesë ligjore që rrjedh nga neni 160 paragrafi 3 i LPK-së, që në dispozitivin

e aktgjykimit të shënohen saktë vendimet me të cilat aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta të palëve, e të cilat kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore. Rrjedhimisht, mbi bazën e të lartcekurave rezulton se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar e ka tejkaluar kërkesëpadinë e paditëses, sa i përket periudhës kohore për të cilat kërkohet kompensimi mbi bazën e kualifikimit, duke i përfshirë në tërësi vitet 2017 dhe 2021, e jo si në kërkesëpadinë e paditëses ku janë përcaktuar decidivisht 9 muaj të vitit 2017 dhe 7 muaj të vitit 2021.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) lidhur me nenin 160 paragrafi 4 të LPK-së, qëndrojnë nga shkaku se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato arsye të cilat janë dhënë janë të mangëta dhe të paqarta. Në këtë rast gjykata është fokusuar në përshkrimin e pretendimeve dhe deklarimeve të palëve dhe në përshkrimin e provave të administruara, pa dhënë analizë për faktet e vërtetuara, për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për vlerën provuese të provave të administruara dhe për kualifikimin e fakteve respektivisht për përfundimin e gjykatës. Pra sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë nuk i ka sqaruar faktet vendimtare si dhe nuk ka dhënë fare arsyesim se mbi bazën e cilave prova ka vlerësuar bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditëses.

Po ashtu edhe gjendja faktike në këtë procedurë nuk del të jetë vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar asnjë provë të vetme konkrete valide për ta arsyetuar vendimin e saj, përveç që i përmend sipërfaqësisht provat e administruara, pa i elaboruar fare të njëjtat, e të cilat në këto rrethana assesi nuk mund të merren si prova të mirëqena, përderisa të njëjtat nuk janë vënë në korrelacion të vlerësimit edhe me provat e tjera eventuale për provimin e fakteve të caktuara. Gjukata e shkallës së parë ka vendosur që ta aprovoj kërkesëpadinë e paditëses, por pa i hetuar dhe shtjelluar të gjitha faktet relevante për këtë procedurë, ndërsa që nuk është sqaruar as aspekti i prekludimit të së drejtës së paditëses në raport me kërkesën e bërë, pasi që arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë për këtë aspekt është tejet konfuz dhe kontradiktor, për faktin se nuk kuptohet se a e ka llogaritur ndonjë afat kohor dhe nëse po, si është llogaritur i njëjti. Mbi bazën e të lartcekurave qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës për vëretimin jo të plotë dhe jo të drejtë të gjendjes faktike në këtë procedurë, pasi që në këtë drejtim mungojnë arsyet për faktet vendimtare dhe mungojnë sqarimet e nevojshme të gjykatës së shkallës së parë, duke mos elaboruar e as sqaruar në mënyrë bindëse dhe të argumentuar se ku qëndrojnë dyshimet apo kontradiktat e këtyre fakteve të saj, përkatësisht provave përmes të cilave synohet që të vërtetohen ato, në raport me provat dhe faktet e parashtruara nga paditësja, e as që ka sqaruar se cilat janë ato fakte apo prova kontestuese dhe përse paraqiten si të tilla. Në këtë drejtim, arsyetimi i dhënë nga gjykata e shkallës së parë nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm për faktin se për një qëndrim të tillë gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme, duke mos sqaruar se cilat janë faktet vendimtare lidhur me bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditëses. Mbi këtë bazë del se edhe gjendja faktike në këtë procedurë nuk është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë.

Për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjykata ankimore vlerëson se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë edhe

në shkelje lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga shkak se e drejta materiale mund të zbatohet drejtë vetëm në rastin kur gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljes së dispozitave të Ligjit të procedurës kontestimore (LPK) nga neni 182 paragrafi 2 pika n) dhe o), lidhur me nenin 160 paragrafi 3 dhe 4 të LPK-së, vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që të priset aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Në riprocedurë gjykata e shkallës së parë, në kuptim të gjetjeve dhe lëshimeve të konstatuara nga gjykata ankimore, udhëzohet që me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike të caktoj seancën përgatitore apo të drejtpërdrejtë të shqyrtimit kryesor (varësisht nga vlerësimi i gjykatës për nevojën e seancës përgatitore), të vërtetojë gjendjen faktike duke vërtetuar saktësisht se kur kërkesa e padisë së paditëses është bërë e arritshme, pastaj me interpretim të drejtë të dispozitës së nenit 87 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës të vlerësojë nëse kërkesa e padisë së paditëses është parashkruar apo jo (pretendim i ngritur nga e paditura gjatë procedimit të çështjes), pastaj nëse gjykata e shkallës së parë gjen se kërkesa e paditëses nuk është parashkruar qoftë në tërësi apo pjesërisht, sipas propozimit të palëve por edhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, të nxjerrë dhe administrojë prova të nevojshme për vërtetimin e faktit vendimtar sa i përket periudhës kohore për të cilën paditëses do t'i takonte kompensimi në bazë të kualifikimit, rrjedhimisht të merren prova edhe sa i përket vërtetimit të saktë të lartësisë së pagës bazë të paditëses për periudhën kohore për të cilën kërkon kompensimin e diferencës së pagës mbi bazën e kualifikimit, ngase në bazë të shkresave të lëndës rezultojnë e paqartë lartësia e pagës bazë të paditëses, duke marrë parasysh faktin se në padinë e parashtruar theksohet se paditësja në bazë të kontratës së punës realizon pagën bazë prej 405.00 €, ndërsa në bazë të listës së pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për pagesën e bërë gjatë periudhës 01.05.2021 deri 31.05.2021, paga bazë e paditëses figuron shuma 421.00 €, ku pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë duke zbatuar dispozitat ligjore të së drejtës materiale do të ketë mundësi të marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në fund udhëzohet gjykata e shkallës së parë që me rastin e përpilimit të aktgjykimit, t'i ketë parasysh kërkesat ligjore që rrjedhin nga dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e Apelit duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare, aktgjykimin e ankimuar e ka prishur edhe në pjesën lidhur me shpenzimet e procedurës të njohura paditëses, pa u lëshuar fare në ligjshmërinë e kësaj pjesë të aktgjykimit të ankimuar, për faktin se kjo lëndë kontestimore u dashtë që të priset dhe gjykatës së shkallës së parë t'i kthehet në rigjykim, me çka pranë asaj gjykate në procedurën e rigjykimit do të krijohen edhe shpenzime tjera procedurale, për të cilat gjykata e shkallës së parë duhet të vendos me rastin e marrjes së aktgjykimit përfundimtar, duke pasur parasysh suksesin e palëve në procedurë dhe dhënies shkas krijimit të shpenzimeve procedurale.

Gjykata e Apelit e vlerësoi edhe kërkesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses të paraqitur në përgjigjen në ankesë, në të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura t'i paguajë shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në ankesë, në shumë prej 208.00 euro, por kjo gjykatë këtë kërkesë e konsideron si të pabazuar, marrë parasysh faktin se përgjigja në ankesë e paditëses nuk ka pasur ndonjë ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje nga ajo që u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (c) të LPKsë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7604/2022, me datë 19.03.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale
Xhennet Shantir

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka d.v